



| | | | |
|--|-------------------------------|-------------------------------|-------------------------------|
| Pranuar / Dorezuar Puniljeno / Prudato Received / Delivery | 27.05.2022 | 2 | viti god. year. |
| Organ / Njesia Organ / Jedinica Org / Unit | Nr Prot Br Prot Prot No | Shtojca Prilog Appendix | Sasia Kolicina Quantity |
| SKDR/SHK | 3129/2022 | | 1/4 |



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.403/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Jeton Koca-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.403/2022 të datës 20.04.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë

kundër Vendimit KD.Nr.01/2022 të datës 23.03.2022 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Drejtësisë, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 27.05.2022, mori këtë:

V E N D I M

HEDHET poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.403/2022 e datës 20.04.2022 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi, i punësuar në Ministrinë e Drejtësisë sipas Akt emërimit të datës 27.10.2017, në pozitën "Drejtor i Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme", në cilësinë e udhëheqësit të drejtpërdrejtë me datën 23.02.2022, ka iniciuar procedurën disiplinore për tek Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Drejtësisë ndaj nëpunësës e punësuar në Ministrinë e Drejtësisë sipas Akt emërimit të datës 25.05.2012 në pozitën "Përkthyes Shqip-Anglisht dhe anasjelltas".

Me datën 22.03.2022 Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Drejtësisë, ka nxjerrë Vendimin me numër KD.Nr.01/2022, sipas të cilit nëpunëses për shkak të shkeljes së rëndë i ka shqiptuar masën disiplinore "Ndalimi i 20% të pagës për një periudhë 1 mujore".

I pakënaqur me shqiptimin e kësaj mase disiplinore nga ana e Komisionit Disiplinor, ankuesi me datën 20.04.2022 ka parashtruar ankesën me numër protokolli 2260/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se vendimi i atakuar me ankesë është i mangët dhe në shpërpushje me shkeljet e rënda disiplinore të konstatuara, sepse i njëjti nuk e ka arrit efektin dhe qëllimin e vet.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 26.04.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses tek Ministria e Drejtësisë. Ndërsa Këshilli me datën 10.05.2022, ka pranuar nga Ministria e Drejtësisë përgjigjen në ankesë, së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me Nr.prot:2260/2022 të datës 20.04.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mailat zyrtar të datës 06.04.2022; Vendimin me numër KD.Nr.01/2022 të datës 22.03.2022 nga Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Drejtësisë; E-mailin zyrtar të datës 22.03.2022; Kërkesën e datës 23.02.2022 për inicimin e procedurës disiplinore; E-mailat zyrtar të datës 22.02.2022 nga palët në procedurë; E-mailin zyrtar të datës 21.02.2022; Vërejtjen me shkrim e shqiptuar nga ankuesi për vartësen e saj për vitin 2021; E-mailin zyrtar të datës 01.07.2021; Kërkesën për kompensim të punës jashtë orarit së bashku me arsyetimin e datës 23.12.2021 për punën jashtë orarit; E-mailin zyrtar të datës 19.12.2021; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 26.04.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 10.05.2022 nga Ministria e Drejtësisë me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Akt emërimit të ankuesit të datës 27.10.2017; Konkursin e brendshëm me numër MD/DFSHP/23-08-01-2017 të datës 23.08.2017 nga Ministria e Drejtësisë; Akt emërimit të ankueses të datës 25.05.2012; Konkursin me numër MD/ZSP/24-02-01-2012 të datës 24.02.2012 nga Ministria e Drejtësisë; Procesverbalet e datës 15.03.2022, 17.03.2022 nga ana e Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Drejtësisë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke i shqyrtuar të gjitha provat e lëndës ka konstatuar që ankesa e ankuesit, është e palejuar, **SEPSE:**

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit KD.Nr.01/2022 të datës 23.03.2022 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Drejtësisë, pretendon që Komisioni Disiplinor në këtë rast ka vendosur në kundërshtim me faktet dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Lidhur me pranueshmërinë e ankesës së ankuesit, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka analizuar dispozitat ligjore në fuqi, duke konstatuar se me nenin 24 paragrafin 3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyratë Publike, përcaktohet se: *“Nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil sipas këtij ligji. E drejta e ankimit në KPMSHC i njihet edhe çdo kandidati në një procedurë pranimit në Shërbimin Civil. Pas shqyrtimit të drejtës së ankimit në KPMSHC, mund të iniciohet konflikt administrativ në gjykatën kompetente për çështjet administrative”,* ndërsa se kush konsiderohet palë në procedurën administrative Kolegji i u referuar nenit 14 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *“1. Palë në procedurën administrative mund të jetë çdo person fizik, person juridik apo grup personash me një interes të përbashkët: 1.1. me kërkesë të të cilit organi publik ka filluar procedura administrative; 1.2. ndaj të cilit ka filluar procedura administrative apo të cilit rezultati i procedurës administrative mund t'i cenojë të drejtat apo interesat juridike. 2. Palë në procedurën administrative janë, gjithashtu, dhe mbrojtësit e interesave publike të autorizuar me ligj të veçantë, si dhe mbrojtësit e interesave kolektive apo të interesave të gjera të publikut, nëse këto interesa mund të cenohen nga rezultati i procedurës administrative”. Ndërsa me nenin 124 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përcaktohet legjitimimi, shkaqet dhe mjetet juridike administrative, ndërsa paragrafi 1 i këtij neni përcakton që: *“Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim. Anëtar i një organi kolegjal, ka gjithashtu të drejtën të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi procedural të organit kolegjal, nëse pretendon se një nga dispozitat e neneve 37-43 të këtij Ligji janë shkelur nga një veprim apo mosveprim i tillë”,* kështu që Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, në këtë rast vlerëson se ankuesit me Vendimin KD.Nr.01/2022 e datës 23.03.2022 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Drejtësisë nuk i janë cenuar asnjë e drejtë nga marrëdhënia e tij e punës, rrjedhimisht nuk ka legjitimitet për parashtrim të ankesës kundër këtij vendimi.*

Bazuar në këtë Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, mund të parashtrinë vetëm nëpunësit civil të cilëve i u janë shkelur të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil, kështu që meqenëse ankesa e ankuesit e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, të Kosovës nuk i plotëson kushtet për parashtrim të ankesës sipas nenit 124 paragrafi 1, nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, atëherë e njëjta konsiderohet se është pa pranueshme.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.403/2022, datë 27/05/2022

Avdyj BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- ❖ *Ankuesit*
- ❖ *Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë*
- ❖ *Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Drejtësisë dhe*
- ❖ *Arkivit të KPMSHCK-së*

